



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 537, datë 12.10.2023

**PËR
CAKIMIN NË SKEMËN E DELEGIMIT TË GJYQTARIT
Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 45 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesës datë 12.07.2023 të gjyqtarit z. {...}, protokolluar pranë Këshillit me aktin nr. 3914, datë 12.07.2023, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...}.
2. Caktimin e gjyqtarit z. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në 3 (tre) vjet, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.
3. Përrjashtimin e gjyqtarit z. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Gjyqtari i skemës së delegimit, z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë që janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare
5. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.
6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR